

**BASHKIA FIER**Nr. 3819/4 Prot.
Dt. 10/04/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 415/1 Prot.Fier, më 08.04.2026

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr.28, Nr.29, Nr.33, Nr.35 të miratuara në mbledhjen e datës 31.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Fier.

BASHKISË FIER ✓**KËSHILLIT TË BASHKISË FIER****Fier**

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. 3819/3 prot. datë 03.04.2025 protokolluar pranë Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 415 prot. datë 07.04.2026 bazuar në ligjin Nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut" (i ndryshuar) neni 4, pika 1, neni 8, shkronja "a", neni 16, Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"(i ndryshuar) neni 13, pika 2 si dhe në ligjin Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, pasi verifikuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Fier, të miratuara në mbledhjen e datës 31.03.2026, mbajtur me procesverbalin e mbledhjes të datës 31.03.2026, Nr. 3819/2 Prot., si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 28 datë 31.03.2026 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Fier", i shoqëruar relacioni Nr.3827/1 prot. datë 25.03.2025, Është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1, shkronja "b", neni 41, pika 1, ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34 pika 6, ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar) neni 3 pika 26, neni 4, neni 32, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore" Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.7 datë 27.02.2026, "Për përgatitjen e programit afatmesëm vendor 2027-2029".

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 29 datë 31.03.2026 "Për një ndryshim në VKB nr. 109,dt 27.11.2025 mbi strukturën,nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026 në lidhje me shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike", është i shoqëruar nga relacioni Nr.3828/1 prot. datë 25.03.2026. është në përputhje Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 54

shkronja "f"; Ligjin Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), neni 5 gërma "c";

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 33 datë 31.03.2025 "Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2026-2028 të Bashkisë Fier", i shoqëruar relacioni Nr.3832/1 prot. datë 25.03.2026, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 54, shkronja "k"; Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"; VKM Nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe të planit të saj të veprimit".

Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier Nr. 35 datë 31.03.2025 "Për miratimin e planit vendor të kujdesit dhe përfshirjes sociale 2026-2028 të Bashkisë Fier", i shoqëruar relacioni Nr.3834/1 prot. datë 25.03.2026, është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1/b, neni 24, neni 54, shkronja "k", si dhe në Ligjin Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë". neni 36, pika 1, shkronja "c"; si dhe në zbatim të VKM Nr. 224, datë 9.4.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Anduel Xhindi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK FIER

Nr. 3834/12 Prot.

Fier më 02.04/2026

VENDIM

Nr. 35, datë 31 / 03 /2026

“Për miratimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026-2028 të Bashkisë Fier”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat vendore”, Ligji Nr.9669/datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrdhëniet familjare" I ndryshuar, VKM-të dhe Udhëzimet zbatuese, Ligji Nr. 18/2017 “Për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe VKM-të zbatuese, Ligji 75/2019 “Për rininë”, Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe VKM-të zbatuese : Sot më datë 31/03/2026, Këshillit të Bashkisë Fier, i paraqitet ky projekt vendim për miratimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale (bashkëngjitur këtij projekti), për ofrimin e shërbimeve sociale për Bashkinë Fier. VKM 150/2019 kërkon që njësitë e vetqeverisjes vendore të kenë të miratuara planet sociale vendore si kusht për përfitimin e fondeve të mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Plani Vendor i Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale bazohet kryesisht tek Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale, duke përfshirë fushat ngushtësisht të lidhura me shërbimet e kujdesit social që synojnë fuqizimin social-ekonomik të grupeve në nevojë, duke përfshirë lehtësimin e aksesit në shërbimet arsimore, strehimin social, shërbimet e punësimit dhe aftësimin, shërbimet ligjore falas, etj. Bazuar sa më lartë, Drejtoria e Politikave dhe Shërbimit Social, propozoi projektvendimin përkatës. Pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, Këshilli Bashkiak Fier,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Vendor të Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale 2026 - 2028 për Bashkinë Fier, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për Zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financë - Buxhetit, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Projekteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT
ANTONETA CUNAJ

